



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 513 Akti

Nr. 455 Vendimi

Tiranë, më 7.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 5.10.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Engert Pëllumbi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bektshi.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Engert Pëllumbi.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Engert Pëllumbi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua Akti i kontrollit me nr. *** prot., datë 11.2.2019, e ILDKPKI-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë

11.6.2019, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Engert Pëllumbi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

9. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr.***, datë 30.7.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti me nr. *** prot., datë 6.11.2020, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.11.2020.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 11.5.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Engert Pëllumbi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 20.9.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 27.9.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 29.9.2021, vendosi të ftojë z. Engert Pëllumbi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 29.9.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.10.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Engert Pëllumbi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2019 ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit Engert Pëllumbi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

24. Z. Engert Pëllumbi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2010, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2010; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2011 – 2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklarinimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

26. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarinimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë

hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi *** datë 11.7.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2013 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. llogari bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”;
2. llogari bankare në “Raiffeisen Bank”;
3. automjet tip “Volkswagen Polo Sedan”, me targa AA *** BO.

1. Llogari bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”

1.1 Subjekti ka deklaruar llogari bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, e krijuar me kursimet nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjendja në datën e deklarimit është në vlerën 700.438.56 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie” të datës 20.1.2017, në “Intesa Sanpaolo Bank”, konfirmohet se subjekti Engert Pëllumbi ka gjendje në llogarinë e pagës vlerën prej 700,438 lekësh, si dhe llogari rrjedhëse në vlerën 22,073 lekë, me burim llogarinë e pagës në të njëjtën bankë.

1.3 Gjendja e llogarisë së pagës në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën e deklaruar nga subjekti vërtetohet edhe me shkresat e bankës nr. *** prot., datë 12.7.2017² dhe nr. *** prot³, datë 17.6.2021.

1.4 Nga verifikimi rezultoi se llogaria është hapur nga subjekti më 24.10.2007. Rezultuan veprime si llogari page, ku janë kaluar të ardhurat e subjektit nga marrëdhëniet e punës ndër vite si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

1.5 Nuk u konstatuan problematika për këtë llogari page me gjendje në vlerën 700,438 me datë 20.1.2017, për të cilën rezultoi se subjekti ka bërë deklarime të sakta.

1.6 Sipas *statement*-it bankar të kësaj banke rezulton se subjekti, në periudhën 2.4.2015 – 3.12.2018, ka kaluar çdo muaj nga llogaria e tij e pagës në llogarinë rrjedhëse një vlerë prej 1,000 lekësh. Në datën e deklaratës *Vetting* (20.1.2017), gjendja e kësaj llogarie rrjedhëse ka qenë në shumën 22,073 lekë.

1.7 Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogarinë rrjedhëse me gjendje 22,073 lekë në datën 20.1.2007. Gjithashtu, u konstatua se kjo llogari ka si burim krijimi të ardhurat nga paga që kalojnë në llogarinë e sipërpërmendur tek “Intesa Sanpaolo Bank”.

²Shihni përgjigjen e “Intesa Sanpaolo Bank” në dosjen e ILDKPKI-së.

³Shihni përgjigjen e “Intesa Sanpaolo Bank” në dosjen e Komisionit.

1.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni, në analizën financiare, përfshiu veprimet e kryera ndër vite nga subjekti për këto llogari bankare. Ndërkohë, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, se përse nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogarinë rrjedhëse në shumën 22,073 lekë dhe burimin e krijimit të saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi, shpjegoi se⁴: *“Konstatimi juaj është plotësisht i drejtë lidhur me shumën prej 22,073 lekësh, me përshkrimin ‘llogari rrjedhëse’. Kjo shumë nuk përbën një llogari rrjedhëse të veçantë, por është plan kursimi, pjesë e llogarisë rrjedhëse (llogarisë së pagës) të hapur pranë ‘Intesa Sanpaolo Bank’. Në momentin që unë kam hapur llogarinë rrjedhëse (llogarinë e pagës) pranë ‘Intesa Sanpaolo Bank’, më 22.1.2015, duhet të kem zgjedhur si obsion edhe hapjen e një plani kursimi bashkëlidhur saj. Kërkoj nga ana e trupës gjyquese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që, kjo pasaktësi e imja në deklaratën e pasurisë në procesin e rivlerësimit të vlerësohet me objektivitet dhe proporcionalitet, në përputhje me pikën 1, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.*

Konkluzion

1.10 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar llogarinë bankare në vlerën 22,073 lekë. Duke qenë se nga hetimi nuk u evidentuan problematika në lidhje me krijimin e kësaj llogarie si nga ana e burimit të krijimit edhe mënyrën e fitimit, Komisioni nuk e konsideron këtë pasaktësi penalizuese për subjektin e rivlerësimit, për aq kohë sa kjo llogari rezultoi si pjesë e llogarisë së pagës së përfituar nga marrëdhëniet e punës.

2. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank”

2.1 Subjekti ka deklaruar llogarinë me nr. ***, në “Raiffeisen Bank”, e krijuar nga shpërbllimi për punën si punonjës akademik i jashtëm në universitetin “A.Xh” Elbasan, në vlerën 43,370.61 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie” të datës 20.1.2017, në “Raiffeisen Bank”, rezultoi se subjekti Engert Pëllumbi ka gjendje vlerën 43,370 lekë, në llogarinë me nr. *** dhe jo në llogarinë me nr. ***.

2.3 Gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, në shumën e deklaruar nga subjekti (por në një llogari tjetër), vërtetohet dhe me shkresat e bankës nr. *** prot., datë 10.7.2017⁵ dhe nr. *** prot⁶., datë 22.6.2021.

2.4 Nga verifikimi i llogarisë bankare rezultoi se llogaria në vlerën 43,370.61 lekë (në momentin e deklaratës *Vetting*) është hapur nga subjekti në datën 25.8.2016. Kjo rezultoi llogari page, ku janë kaluar të ardhurat e subjektit nga marrëdhëniet kontraktuale me universitetin “A.Xh” në Elbasan.

2.5 Sipas *statement*-it bankar të “Raiffeisen Bank” duket se llogaria me nr. ***, e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, është hapur në datën 14.5.2007 (para fillimit të detyrës dhe para fillimit të Shkollës së Magjistraturës) dhe është mbyllur në datën 4.12.2013.

⁴Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit të dërguar nga Komisioni.

⁵Shihni përgjigjen e “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶Shihni përgjigjen e “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

- 2.6** Në përfundim të hetimit, Komisioni konkludoi se në analizën financiare janë përfshirë veprimet e kryera, ndër vite, nga subjekti për këto llogari bankare, por, subjekti duhet të japë shpjegime se përse nuk e ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* numrin e llogarisë bankare të krijuar nga të ardhurat si punonjës akademik në universitetin “A.Xh”, Elbasan.
- 2.7** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi shpjegoi se: *“Konstatimi juaj është plotësisht i drejtë. Rezulton që unë të kem hapur pranë ‘Raiffeisen Bank’ një llogari rrjedhëse me nr. ***, në datën 14.5.2007 (përpara fillimit të detyrës dhe përpara fillimit të Shkollës së Magjistraturës) dhe e mbyllur në datën 4.12.2013. Më tej, rezulton të kem hapur sërish llogari rrjedhëse pranë ‘Raiffeisen Bank’, me nr. ***, llogari e krijuar nga të ardhurat si pedagog i jashtëm pranë universitetit ‘A.Xh’, Elbasan. Ky gabim në identifikimin e numrit të llogarisë nga ana ime është një lapsus dhe deklaroj me përgjegjësi të plotë se bëhet fjalë thjeshtë dhe vetëm për një gabim material. Pra, llogaria rrjedhëse pranë ‘Raiffeisen Bank’ është deklaruar nga ana ime dhe, njëkohësisht, ajo disponohet si provë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 2.8** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit arriti të paraqesë argumente bindëse në lidhje me mosdeklarimin e saktë të numrit të llogarisë bankare të krijuar nga të ardhurat si punonjës akademik në universitetin “A.Xh”, Elbasan.
- 2.9** Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë një lapsus në deklarimin e numrit të llogarisë bankare, ka burime të ligjshme për këtë llogari bankare, duke u ndodhur kështu në kushtet e përcaktimeve të germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “Volkswagen Polo Sedan”, me targa AA * BO**

- 3.1** Subjekti ka deklaruar automjetin tip “Volkswagen Polo Sedan”, blerë me kontratën nr. ***, datë 13.10.2011, me notere M.Ll, me para të dhuruara nga shtetasi S.P, babai i subjektit, në vlerën 5,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 3.2** Për këtë automjet rezultoi certifikatë e pronësisë së automjetit, me targa AA *** BO, në emër të shtetasit Engert Pëllumbi, si dhe leja e qarkullimit.
- 3.3** Rezultoi se automjeti është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.10.2011, me palë shitëse A.R dhe palë blerëse Engert Pëllumbi, në shumën 5,000 euro.
- 3.4** Për këtë veprim shitjeje është lëshuar edhe faturë tatimore me nr. ***, datë 31.5.2008 dhe deklaratë doganore e automjetit datë 11.4.2008.
- 3.5** Lidhur me burimin e blerjes së pasurisë, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.10.2016, ku konfirmohet se shtetasi S.P i ka dhuruar djalit të tij Engert Pëllumbi, subjekt i rivlerësimit, vlerën 5,000 euro me qëllim blerjen e automjetit tip “Volkswagen Polo”, vit i prodhimit 2006.
- 3.6** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerje automjeti në vlerën 5,000 euro me shumën e dhuruar nga shtetasi S.H.P, babai i deklaruesit.

3.7 DPSHTRR-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 27.7.2017 dhe datë 18.7.2017⁷, si dhe nr. *** prot., datë 18.6.2021⁸, konfirmon automjetin në pronësi të subjektit dhe veprimet e kryera sipas deklarimeve të tij.

3.8 QKB-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 2 4.7.2017 dhe nr. *** prot. datë 14/06/2021, konfirmon se shtetasi S.P, i datëlindjes 10.2.1952, figuron i regjistruar si person fizik i pajisur me NIPT ***. Ekstrakti historik i QKB-së konfirmon licencë –shërbime ekspertize, lëshuar me nr. ***, statusi “aktiv”.

3.9 DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 7.8.2017, ka konfirmuar se shtetasi S.P figuron i regjistruar si person fizik, me aktivitet shërbimi kundër zjarrit, me të dhëna si vijojnë:

Xhirot e deklaruara, ndër vite, sipas deklarimeve të tatim-fitimit të thjeshtuar janë si vijon:

Viti	Të ardhurat	Shpenzimet	Fitimi
2014	820.000 lekë	255.658 lekë	564.343 lekë
2015	507.000 lekë	25.952 lekë	481.048 lekë
2016	1.079.500 lekë	44.752 lekë	1.034.748 lekë

3.10 ISSH-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 18.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 14.6.2021, konfirmon se shtetasi S.P ka realizuar të ardhura me punëdhënës “E.T” me NIPT ***, për vitet 2012 – 2021 dhe punëdhënës shoqërinë “S.P”, me NIPT ***, për periudhën janar 2012 – 2021.

3.11 APP-ja, me shkresën nr. ***, datë 25.5.2018⁹, lidhur me shtetasin S.P konfirmon se nuk është i regjistruar në sistem dhe, për pasojë, nuk ka marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronike deri më 20.1.2017.

3.12 Për të provuar mundësitë financiare lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait, subjekti ka paraqitur vërtetim page nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga shoqëria “E.T” sh.p.k., për punësimin e tij për periudhën 1.10.2001 – 30.9.2016, ku rezulton përfitimi i shumës prej 11,533,938 lekësh.

3.13 Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 11.4.2008, nga ISSH-ja, ku vërtetohen të ardhurat e siguruara nga babai i subjektit, z. S.P. Këto të ardhura (pas konstatimit të pagimit të detyrimeve tatimore) janë përfshirë në analizën financiare për të analizuar mundësinë financiare të babait të subjektit, për të blerë apartamentin në vitin 2008, në vlerën 2,800,000 lekë, si dhe për t’i dhuruar subjektit shumën prej 5,000 euro, për blerjen e automjetit në vitin 2011.

3.14 Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me analizimin e mundësive të dhuruesit, babait të subjektit, për t’i dhuruar subjektit shumën 5,000 euro.

Analiza financiare

Të ardhura S.P 2001 – 10.10.2011	7,187,056
Të ardhura N.P 2001 – 10.10.2011	724,030
Të ardhura totale 2001 – 10.10.2011	7,911,086
Shpenzime jetese 2001 – 10.10.2011	3,251,409
Blerë apartament në Tiranë datë 3.4.2008	2,800,000

⁷Shihni përgjigjet e DPSHTRr-së në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸Shihni përgjigjen e DPSHTRr-së në dosjen e Komisionit.

⁹Shihni përgjigjen e APP-së në dosjen e ILDKPKI-së.

Dhurim E.P - 5,000 euro – 10.10.2011	691,500
Shpenzime totale	6,742,909
Mundësi huadhënieje 5,000 euro dhe blerje apartamenti	1,168,177

3.15 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj. Bazuar në analizën financiare rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi financiare për blerjen e pasurisë apartament (në vitin 2008) dhe, më pas, dhurimin e shumës prej 5,000 euro subjektit, datë 10.10.2011, si dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2001 – 10.10.2011.

4. Detyrime financiare

4.1 Subjekti ka deklaruar detyrime financiare lidhur me qiranë e banesës ku jetonte dhe ushtronte detyrën e gjyqtarit në qytetin e Fierit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.2 Rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë qiraje noteriale me nr. ***, datë 4.1.2017, për harkun kohor 1.1.2017 - 31.12.2017, me shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator z. L.L, për marrjen me qira të apartamentit me sip. 103.4 m², në lagjen “****”, Fier, kundrejt çmimit 17,000 lekë/muaj. Kjo pasuri është deklaruar se është në proces regjistrimi në ZVRPP Fier nga shoqëria “****” sh.p.k.

4.3 Subjekti ka deklaruar se nuk ka mbetur ndonjë shumë e pashlyer, pasi detyrimi është mujor dhe i paguar paraprakisht në fillim të muajit, në vlerën 17,000 lekë, palës qiradhënëse.

4.4 Kontratës së qirasë së datës 4.1.2017 i është bashkëngjitur planimetria e objektit, leja e ndërtimit, kopja e kartës së identitetit dhe ekstrakti i shoqërisë “****” sh.p.k., si palë qiradhënëse.

4.5 ZVRPP-ja Fier, me e-mail-in e datës 11.2.2019¹⁰, konfirmon se shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. ka të regjistruar pasurinë pallat, në z. k. ***. Nga verifikimi i kartelave të pasurisë objekt në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me sip. 103.4 m², rezultojnë të regjistruara 6 apartamente, nga të cilat 5 prej tyre rezultojnë në pronësi të kësaj shoqëri.

4.6 Edhe në rubrikën “të dhënë konfidenciale” në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sipërfaqe 103.4 m², i ndodhur në lagjen ‘***’ të qytetit të Fierit, send i cili është në proces regjistrimi në ZVRPP-në Fier, i marrë me qira prej meje për periudhën 1.1.2017 - 31.12.2017, kundrejt çmimit 17,000 lekë/muaj. Kontratë qiraje nr. ***, datë 4.1.2017*”.

4.7 Subjekti është pyetur që të provojë zgjidhjen e kontratës së qirasë dhe mosrealizimin e saj për periudhën 1-vjeçare.

4.8 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: “*Në datën 4.1.2017 kam lidhur kontratën e qirasë me shoqërinë ‘***’ sh.p.k., për një periudhë 1-vjeçare, nga data 1.1.2017 deri në datën 31.12.2017. Në nenin 6 të kësaj kontrate është parashikuar se në kushte normale, kjo kontratë përfundon në fund të afatit të caktuar. Megjithatë, në rast të nevojës së prishjes së kontratës së qirasë për arsye objektive, atëherë palët duhet të lajmërojnë njëra - tjetrën një muaj përpara.*”

*Rezulton se me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, jam komanduar në detyrën e ndihmës magjistratit pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë*

¹⁰Shihni përgjigjen me e-mail të ZVRPP-së Fier në dosjen e ILDKPKI-së.

*trevjeçare. Për sa më sipër, duke qenë se që nga data 10.2.2017 nuk e kam ushtruar më detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e kam përfunduar kontratën e qirasë të datës 4.1.2017, të lidhur me shoqërinë “*** sh.p.k., pasi nuk kam pasur më asnjë arsye për të mbajtur një banesë me qira në qytetin e Fierit, qytet në të cilin kam qenë rezident për periudhën nga data 1.1.2016 deri në fund të muajit shkurt të vitit 2017, vetëm për shkak të punës.*

*Deklarata noteriale datë 14.7.2021, e administratorit të shoqërisë “*** konfirmon faktin se kontrata e datës 4.1.2017, e lidhur mes meje dhe shoqërisë së tij, është ndërprerë në fund të muajit shkurt 2017 për arsye të transferimit tim në Tiranë”.*

4.9 Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumente ku rezultoi:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.7.2021, e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. L.L, e hartuar përpara noterit G.R.M, me anë të së cilës theksohet se kontrata e qirasë është ndërprerë në fund të shkurtit të vitit 2017, për shkak të transferimit të subjektit në Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2017, me lëndë “njoftim vendimi”, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në të cilën rezultoi se subjekti i rivlerësimit është komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit pranë Gjykatës së Lartë;
- vendimi nr. ***, datë 10.2.2017, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me anë të të cilit subjekti është komanduar pranë Gjykatës së Lartë si ndihmës magjistrat për një periudhë 3-vjeçare;
- urdhër nr. ***, datë 21.2.2017, i kryetarit të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit subjekti ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Gjykatës së Lartë më datë 22.2.2017.

4.10 Në përfundim të hetimit, Komisioni konkludoi se nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit. Në analizën financiare janë pasqyruar shpenzimet e qirasë në qytetin e Fierit për harkun kohor janar- dhjetor 2016.

Konstatime të tjera gjatë hetimit

5. Banesë e përdorur, ndër vite, nga subjekti

5.1 Subjekti ka deklaruar se ka jetuar në Tiranë nga momenti i marrjes së detyrës, në periudhën 27.9.2010 – 31.12.2015. Gjatë kësaj periudhe ka banuar në Njësinë Administrative Nr. ***, “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, z.k. ***.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 5.2** Kjo pasuri, apartament me sip. 63 m², është deklaruar si adresë banimi edhe në deklaratat periodike vjetore.
- 5.3** Rezultoi se pasuria në fjalë është në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit, e përfituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 3.4.2008, në vlerën 2,800,000 lekë (shitur nga vëllai S. P dhe motra D.P).
- 5.4** Pasuria apartament është përfituar, fillimisht, nga babai i subjektit me anë të trashëgimisë ligjore së bashku me dy trashëgimtarë të tjerë, S. P. dhe D. P., (më 3.7.2007). Trashëgimia është përfituar me nr. *** akti dhe nr. *** vendimi, datë 3.7.2007 (vendim për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë). Pasuria është regjistruar në emër të 3 trashëgimtarëve (vërtetuar me certifikatën e pronësisë së datës 10.8.2007) dhe pastaj i është shitur babait të subjektit të rivlerësimit në vitin 2008.

- 5.5 FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2021, nuk konfirmon se për subjektin Engert Pëllumbi dhe për babain S.H.P të ketë kontratë për furnizim me energji elektrike. Gjithashtu, edhe UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2020, konfirmon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata shërbimi, lidhur me këta shtetas.
- 5.6 Lidhur me mundësitë financiare të babait të subjektit për blerjen e kësaj pasurie referojuni tabelës dhe analizës financiare në pikën 3.14 dhe 3.15 më sipër.
- 5.7 Nisur nga fakti se kjo pasuri është përfituar, fillimisht, nga babai i subjektit me anë të trashëgimisë dhe pastaj me blerje nga trashëgimtarët e tjerë në vitin 2008, periudhë në të cilën subjekti nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit (është emëruar magjistrat në dhjetor të vitit 2011), si dhe nga analiza financiare mbi mundësitë e blerjes, nuk kanë lindur dyshime për këtë pasuri në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.
- 5.8 Në përfundim të hetimit të llogaritjes së bërë në analizën financiare, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit duket se ka pasur burime të ligjshme për shtim pasurish dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

6. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi

PËRSHKRIMI	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	-68,217	698,446	229,783	90,477	110,313	185,240	278,555	691,500
Automjet tip "Volkswagen Polo", me targa AA *** BO - 2011		691,500						691,500
Ndryshim në likuiditet	-68,217	6,946	229,783	90,477	110,313	185,240	278,555	

DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0
								0
								0

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	-68,217	698,446	229,783	90,477	110,313	185,240	278,555	691,500

TË ARDHURA dokumentuar	588,554	1,524,578	878,637	844,397	1,050,105	1,027,706	1,095,230	7,009,207
Të ardhura nga puna e subjektit Engert Pëllumbi	588,554	833,078	878,637	844,397	1,050,105	1,027,706	1,095,230	6,317,707
Të ardhura nga dhurimi S.P - 5,000 euro - 2011	0	691,500	0	0	0	0	0	691,500

SHPENZIME	156,620	226,620	389,548	141,725	311,070	316,922	521,003	2,063,507
Shpenzime jetese	136,620	136,620	139,548	141,024	219,998	224,276	235,092	1,233,178
Shpenzime qiraje Fier - 2016							204,000	204,000
Shpenzime shkollimi Universiteti i Tiranës		50,000						50,000

Shpenzime për dërgesa drejt T.K.	20,000	40,000						60,000
Shpenzime udhëtimit	0	0	250,000	701	91,072	92,646	81,911	516,329

Analiza dokumentuar	500,151	599,512	718,872	612,195	628,723	525,543	295,672	3,880,668
----------------------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	------------------

6.1 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

- a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë “Credins Bank”, “Raiffeisen Bank”, BKT-ja, “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.
- b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
 - i) të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2010 – 2011, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për vitet 2011 – 2016, si dhe në universitetin “A.Xh”, Fier, në vitin 2016;
 - ii) të ardhurat nga pagat e babait të subjektit në shoqërinë “E.T” sh.p.k., në vitet 2001 - 2011;
 - iii) të ardhurat nga puna e nënës së subjektit, të vërtetuara nga DRSSH-ja Elbasan (2002 – 2006).
- c. Shpenzimet, ku përfshihen:
 - i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);
 - ii) shpenzime udhëtimit për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. ***, datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe udhëtime me qëndrim pranë të afërmeve;
 - iii) shpenzim për shkollimin në Universitetin e Tiranës (viti 2011), sipas statementit nga “Raiffeisen Bank”;
 - iv) shpenzim për dërgesat drejt T. K. (2010 – 2011), sipas statementit nga “Raiffeisen Bank”;
 - v) shpenzime për qira (2016), sipas kontratës së qirasë.
- ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive¹¹.

Për sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë

¹¹Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës, në përputhje me parashikimet e pikës 4, të nenit 4 dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë 31.10.2017 dhe nr. *** prot., datë 30.7.2021, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.7.2021, të KDZh-së, ku rezultoi se:

- Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.

Për subjektin e rivlerësimit rezultoi të jetë regjistruar një procedim penal nr. ***, në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, transferuar më pas në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë.

Procedimi penal është pushuar me vendimin e datës 7.1.2016.

Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në këndvështrimin e përgjithshëm të integritetit dhe pastërtisë së figurës së një punonjësi të sistemit të drejtësisë, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të si funksionar publik apo personat e lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit apo personave të tjerë, cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të germës "c", të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, konstatohet *papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi.*

Lidhur me raportin për vlerësimin e figurës, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë prova në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se:

- *DSIK-ja arrin në përfundime që jo vetëm janë kundërthënëse me faktet e përshkruara më sipër, por bën vlerësime që janë në kundërshtim me parimet e kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit, si dhe në tejkalim të kompetencave të këtij organi.*
- *Raporti i përgatitur nga DSIK-ja, me të cilin është arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, vjen në kundërshtim me nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e ligjit nr. 84/2016.*
- *Komisioni të mos e marrë në konsideratë raportin e Grupit të Punës së ngritur pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe ta konsiderojë subjektin e rivlerësimit Engert Pëllumbi si të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës nga pikëpamja e figurës.*

Komisioni vlerëson se referuar dispozitave Kushtetuese dhe ligjore (ligji nr. 84/2016) shkak për të cilën një subjekt rivlerësimi mund të shkarkohet lidhet me: (a) subjekti nuk dorëzon deklaratën për figurën në kohë; (b) provohet se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) subjekti përpiqet të bëjë deklaramime të pasakta ose të fshehtë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- i. Bazuar në të dhënat e administruara nga Komisioni, rezultoi se formulari i deklaramit për figurën është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016. Subjekti i

rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në “Deklaratën për kontrollin e figurës”.

- ii. Institucionet e tjera ndihmëse në kuadrin e procesit për vlerësimin e figurës, kanë deklaruar mospasje të *indicieve* për përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Sipas dispozitave ligjore në fuqi (pika 6, e neni 3, të ligjit nr. 84/2016), kontakt i papërshtatshëm konsiderohet një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Sipas pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, me person të përfshirë në krimin e organizuar kuptohet çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

Nga provat e administruara nga Komisioni dhe praktikrat e administruara nga organet e tjera ndihmëse në kuadrin e vlerësimit të figurës nuk u provua që subjektit i rivlerësimit të këtë pasur ndonjëherë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- iii. Subjekti ka bërë deklarime të sakta në formularin e deklarimit të figurës dhe nuk është përpjekur të fshehë fakte apo kontakte, si dhe nuk është përpjekur të pasqyrojë në mënyrë të pasaktë rrethana të caktuara. Për subjektin e rivlerësimit rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. ***, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, transferuar më pas në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë, por ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 7.1.2016. Në momentin e plotësimit të formularit të deklarimit të figurës, subjekti nuk ka qenë në kushtet e ndjekjes penale.

Komisioni konstatoi se për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo kontakte të papërshtatshme.

Në përfundim, në kuadrin e verifikimit të figurës, Komisioni arrin në konstatimin se nuk ekziston asnjë prej tri rrethanave ligjore, për të cilat mund të shkarkohet subjekti i rivlerësimi.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime të qarta dhe të plota dhe referuar kërkesave të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti, për vlerësimin profesional të subjektit, u përgatit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në

ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe
- 3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular dhe dokumentacionit bashkëngjitur të paraqitur prej tij, konstatohet se, nga tetori i vitit 2010 deri në nëntor të vitit 2011, subjekti ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në muajin dhjetor të vitit 2011 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, të KLD-së është lejuar për të shërbyer si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë dhe me vendimin nr. ***, datë 23.1.2020, të KLGJ-së i është zgjedhur komandimi edhe 1 vit. Gjithashtu, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 27.10.2020, të KLGJ-së është vendosur komandimi i gjyqtarit Engert Pëllumbi në skemën e delegimit dhe është caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për periudhën, deri më 5.11.2021.

Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka deklaruar se tri vitet e fundit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, duke kryer çdo proces që lidhet me këtë veprimtari deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës civile.

Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1379 çështje, ka përfunduar gjithsej 1382 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 107 çështje të vitit 2016.

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor pezullimi. Një vendim civil pezullimi i përket vitit 2014 dhe dy vendimet e tjera civile të pezullimit, i përkasin vitit 2016.

❖ Konstatimet mbi tri dokumentet ligjore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 - Vendimi i pezullimit për çështjen civile nr. *** akti, datë 12.6.2014 regj, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që i përket paditësit A.M, me të paditur shoqërinë përmbarimore “***” sh.p.k., person i tretë “Raiffeisen Bank”, me objekt “anulimin e veprimeve përmbarimore...”.

Me këtë vendim, ku gjyqtari Engert Pëllumbi ka qenë gjyqtar i vetëm, në seancën gjyqësore të datës 2.9.2014 ka vendosur: *“Pezullimin e gjykimit të çështjes me nr. *** akti. Dërgimin e materialeve të saj në Gjykatën Kushtetuese, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e fjalisë së dytë, të paragrafit të pestë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile”*.

Nuk pasqyrohet në akte vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me këtë çështje.

Nga analiza e përmbajtjes së vendimit të pezullimit, rezulton se shqyrtimi i çështjes është zhvilluar në seancë gjyqësore nga gjyqtari Engert Pëllumbi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por pa pasqyruar praninë ose jo të palëve ndërgjyqëse. Seanca është zhvilluar dhe vendimi i pezullimit është shpallur në datën 2.9.2014. Në tekstin e vendimit është shënuar data e

regjistrimit të çështjes civile më 12.6.2014. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes për pezullim është 2 muaj e 20 ditë.

Nga struktura e vendimit të pezullimit, vërehet se përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese, janë parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes lidhur me objektin e kërimit të paditësit. Në nënpjesën e dytë, është përshkruar vlerësimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është analizuar për lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës procedurale civile që çmohet si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, duke konstatuar se plotësohet ekzistenca e tre elementeve të domosdoshëm. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka mbërritur në çmuarjen e antikushtetutshmërisë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, me Kushtetutën dhe, për pasojë, duhet të pezullohet gjykimi i çështjes dhe të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. Në pjesën e fundit të vendimit gjendet dispozitivi, i cili është i shkruar qartë. Disponohet për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Tregohet se kundër vendimit nuk lejohet ankim, shkak për të cilin ka arsyetuar edhe në vendim.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së çështjes. Konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe, po ashtu, edhe të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 22 fletë gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 122,2013, ligjit nr. 8116, datë 20.3.1996, Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 6, datë 17.2.2012, nr. 30, datë 17.6.2010, nr. 12, datë 14.4.2010, nr. 1/2011, nr. 11/2013, nr.75/2002, nr. 76/2002, nr. 17/2010 të Gjykatës Kushtetuese, Vendimi Unifikues nr. 13, datë 24.3.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të SHBA-së. Gjyqtari ka përdorur në arsyetim parime si: *“legislative due process”*, etj.

Dokumenti 2 - Vendimi i pezullimit për çështjen civile me nr. *** akti, datë 27.1.2015 regj, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që i përket paditësit të kundërpaditur Z.B, me të paditur kundërpaditës V.S, me objekt të padisë “lirimin e dorëzimit të sipërfaqes tokë arë...” dhe objekt të kundërpadisë “detyrimin për njohjen pronar me parashkrim fitues të pasurisë tokë arë...”.

Me këtë vendim, ku gjyqtari Engert Pëllumbi ka qenë gjyqtar i vetëm, në seancën gjyqësore të datës 15.3.2016 ka vendosur: *“Pezullimin e gjykimit të çështjes. Dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, si dhe t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese të shpallë antikushtetues nenin 168/1 të Kodit Civil, në pjesën që nuk parashikon fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, bazuar në një titull të ndryshëm nga veprimi juridik”*.

Nuk pasqyrohet në akte vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me këtë çështje.

Nga analiza e përmbajtjes së vendimit të pezullimit, rezulton se shqyrtimi i çështjes është zhvilluar në seancë gjyqësore nga gjyqtari Engert Pëllumbi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por pa pasqyruar praninë ose jo të palëve ndërgjyqëse. Seanca është zhvilluar dhe vendimi i pezullimit është shpallur në datën 15.3.2016. Në tekstin e vendimit është shënuar data e regjistrimit të çështjes civile më 27.01.2015. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes për pezullim është 1 vit 1 muaj e 16 ditë.

Nga struktura e vendimit të pezullimit, vërehet se përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe

kundërpadisë, si dhe baza ligjore. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese, janë parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes, lidhur me objektin e kërimit të paditësit dhe kundërpaditësit. Në nënpjesën e dytë, është përshkruar vlerësimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është analizuar për lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës materiale civile që çmohet si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, lidhur me njohjen pronar të poseduesit jo pronar, duke konstatuar se plotësohet ekzistenca e tri elementeve të domosdoshëm. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka mbërritur në çmuarjen antikushtetues të nenit 168/1 të Kodit Civil me Kushtetutën dhe, për pasojë, duhet të pezullohet gjykimi i çështjes dhe të dërgohet çështja në Gjykatën Kushtetuese. Në pjesën e fundit të vendimit gjendet dispozitivi, i cili është i shkruar qartë. Disponohet për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Tregohet se kundër vendimit nuk lejohet ankimi, shkak për të cilin ka arsyetuar edhe në vendim.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së çështjes. Konstatohet se janë respektuar gjithmonë rregullat e drejtshkrimit dhe, po ashtu, janë përdorur edhe të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm në 17 fletë gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, Kodi Civil të vitit 1929, vendimit unifikues nr. 2, datë 10.3.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Dekreti nr. ***, datë 6.7.1955, “Mbi pronësinë”, Kodit Civil Italian, Kodit Civil Francez, Kodi Civil Gjerman, ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese, vendimit nr. 11, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese, vendimit unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe të praktikës gjyqësore e GJEDNj-së dhe Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane e vitit 1958. Gjyqtari ka përdorur në arsyetim parime si: “e drejta për jetën”, “barazia e shtetasve para ligjit”, “locus standi”, etj.

Dokumenti 3 - Vendimi i pezullimit për çështjen civile me nr. *** akti, datë 27.1.2015 rregj., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që i përket paditëses M.M, me të paditur shoqëria e sigurimeve INSIG, me objekt “detyrimin për pagimin e dëmit real, pasuror dhe jopasuror, kamatëvonesat për shkak të vdekjes së shtetasës ...”.

Me këtë vendim, ku gjyqtari Engert Pëllumbi ka qenë gjyqtar i vetëm, në seancën gjyqësore të datës 22.6.2016, ka vendosur: “Pezullimin e gjykimit të çështjes. Dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, si dhe t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese të shpallë antikushtetues nenin 26, pika 2, germa “b”, të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar”.

Nuk pasqyrohet në akte vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me këtë çështje.

Nga analiza e përmbajtjes së vendimit të pezullimit, rezulton se shqyrtimi i çështjes është zhvilluar në seancë gjyqësore nga gjyqtari Engert Pëllumbi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por pa pasqyruar praninë ose jo të palëve ndërgjyqëse. Seanca është zhvilluar dhe vendimi i pezullimit është shpallur në datën 22.6.2016. Në tekstin e vendimit është shënuar data e regjistrimit të çështjes civile më 27.1.2015. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes për pezullim është 1 vit e 4 muaj e 25 ditë.

Nga struktura e vendimit të pezullimit, vërehet se përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese, janë parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes për objektin e kërimit të paditëses, lidhur me dëmshpërblimin për aksidentin e nënës së saj. Në nënpjesën e dytë, është përshkruar vlerësimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është analizuar për lidhjen e drejtpërdrejtë midis nenit 26, pika 2, germa “b”, të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, që çmohet si antikushtetues dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, duke konstatuar se plotësohet ekzistenca e tre elementeve të domosdoshëm. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka mbërritur në çmuarjen e antikushtetutshmërisë së këtij neni të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, me Kushtetutën dhe, për pasojë, duhet të pezullohet gjykimi i çështjes dhe të dërgohet çështja në Gjykatën Kushtetuese. Në pjesën e fundit të vendimit gjendet dispozitivi, i cili është i shkruar qartë. Disponohet për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Tregohet se kundër vendimit nuk lejohet ankim, shkak për të cilin ka arsyetuar në vendim.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së çështjes. Konstatohet se janë respektuar gjithmonë rregullat e drejtshkrimit dhe, po ashtu, janë përdorur edhe të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 21 fletë gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit Civil, vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dekretit nr. ***, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike...”, ligjit nr. 7641, datë 1.12.1992, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 39, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese, vendimit nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese, ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, vendimit nr. 26, datë 2.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese, vendimit nr. 41, datë 9.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe praktikës gjyqësore dhe Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane e vitit 1962, KEDNj-së, etj.

Gjyqtari ka përdorur në arsyetim parime si: “*siguria juridike*”, “*barazia e shtetasve para ligjit*”, “*e drejta e pronës*”, etj.

Analiza e Komisionit

Referuar tri dokumenteve të zgjedhura të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit rezulton se këto tri vendime janë kërkesa për të pezulluar gjykimin dhe për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese (kontroll incidental i kushtetutshmërisë së ligjeve):

Dokumenti 1 - Vendim për pezullimin e çështjes civile akt nr. *** regj., datë 12.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të gjykuar për kushtetutshmërinë e fjalisë së dytë të paragrafit 5, të nenit 610, të Kodit të Procedurës Civile (vendimi 2 muaj dhe 20 ditë pas regjistrimit të çështjes).

Dokumenti 2 - Vendim për pezullimin e çështjes civile akt nr. *** regj., datë 27.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për kushtetutshmërinë e nenit 168/1 të Kodit Civil (çështja është regjistruar më 27.1.2015, vendimi për pezullim është më 15.3.2016 - pas 1 viti, 1 muaj dhe 16 ditë, jashtë afatit standard 6 muaj).

Dokumenti 3 - Vendim për pezullimin e çështjes civile akt nr. *** regj., datë 27.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për kushtetutshmërinë e nenit 26, paragrafi 2, germa “b”, të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për

sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (çështja e regjistruar më 27.1.2015, vendimi për pezullim i datës 22.06.2016 -1 vit, 4 muaj dhe 25 ditë, jashtë afatit standard 6 muaj).

Sa më sipër, konstatohet se në dy nga çështjet e mësipërme, si dhe vendimet për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e tyre në Gjykatën Kushtetuese janë marrë me vonesa të konsiderueshme (shihni dokumentet 2 dhe 3).

Gjithashtu, vlen të theksohet se kur një gjyqtar vendos për një kontroll incidental dhe investon Gjykatën Kushtetuese dhe kur kjo e fundit e gjen një ligj apo dispozitë të tij antikushtetues, shoqëria përfiton sepse një vendim i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm për të gjithë. Vendimi i një gjykate të sistemit të zakonshëm, kur vendos mbi një mosmarrëveshje civile është i detyrueshëm *inter partes*. Kurdoherë, që një gjyqtar pezullon gjykimin e një mosmarrëveshje midis palëve dhe dërgon një ligj në Gjykatën Kushtetuese, palët në mosmarrëveshjen specifike do të “vuajnë” nga vonesat e mundshme. Për shkak të kësaj gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e mjeteve të tilla. Ndërsa kontrolli incidental është i garantuar nga Kushtetuta, është e rëndësishme që gjyqtarët të mos abuzojnë me këtë të drejtë në dëm të efikasitetit dhe zgjidhjes së duhur të mosmarrëveshjeve me palët aktuale, ose ta shfrytëzojnë atë si një “mundësi” për të vonuar ose shmangur vendimmarrjen për një çështje të caktuar.

Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për informacion dhe dokumentacion për ecurinë e shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe vendimet e mundshme të Gjykatës Kushtetuese për këto çështje.

Komisioni, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021, është njohur me vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese për këto tri (3) raste.

Nga informacioni në lidhje me vendimin që korrespondon me dokumentin 1, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 12.6.2014 dhe gjyqtari Engert Pëllumbi ka dalë me vendimin për pezullimin e çështjes civile nr. ***, datë 12.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të gjykuar për kushtetutshmërinë e fjalisë së dytë të paragrafit pesë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile (vendimi 2 muaj dhe 20 ditë pas regjistrimit të çështjes).

Me vendimin nr. ***, datë 17.2.2015, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, i përbërë prej 9 gjyqtarësh, vendosi: *“Rrëzimin e kërkesës me argumentimin se, në analizë të kriterit të legjitimitetit ‘arsye serioze për antikushtetutshmëri’. Gjykata vëren se, gjykata referuese nuk argumenton mjaftueshëm në nivel kushtetues shkeljen e të drejtave të debitorit për një fazë përmblyëse të procesit, që nga pikëpamja e themelit për të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile të palëve kontraktuale është përfunduar, ndërkohë që, nga ana tjetër, afati prezumohet t’i shërbejë përshpejtimit të procesit gjyqësor në funksion të përfundimit të fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë në fushën e kredive bankare dhe institucioneve jobankare.*

Megjithatë, gjykata konstaton se gjykatës referuese i ka paraqitur kërkesë debitori me objekt anulimin e veprimeve përmbartimore dhe marrjen e masës së pezullimit ndaj veprimeve përmbartimore të mëtejshme, konkretisht shitjen e sendit në ankand, veprim procedural të cilin gjykata referuese nuk kishte pengesë që ta ndërmernte me vendim të ndërmjetëm, referuar nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nga shqyrtimi i normës ligjore, objekt kundërshtimi për antikushtetutshmëri, nuk varet zgjidhja përfundimtare e çështjes në shqyrtim”.

Nga informacioni në lidhje me vendimin që korrespondon me dokumentin 2, rezulton se, çështja është regjistruar në gjykatën e rrethit gjyqësor Fier më 27.01.2015. Më datë 15.03.2016, pas 1 viti, 1 muaj dhe 6 ditë-jashtë afatit standard 6 muaj për një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjes -gjyqtari ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes dhe t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese kushtetutshmërinë e nenit 168/1 të Kodit Civil.

Në datën 13.5.2016 (2 muaj pas vendimit të pezullimit), Kolegji i Gjykatës Kushtetuese i përbërë prej 3 gjyqtarësh, përmes vendimit nr. ***, datë 13.5.2016, refuzoi kërkesën duke e gjetur atë të pabazuar dhe pa argumente serioze në nivel Kushtetues duke argumentuar si vijon:

“Gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t`i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (shihni vendimin nr. 55, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se, ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t`i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (shihni vendimet nr. 4, datë 23.2.2016; nr. 22, datë 11.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

Po ashtu, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131 të Kushtetutës në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, kurse mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (shihni vendimin nr. 2, datë 3.2.2009, të Gjykatës Kushtetuese).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në standardet e sipërcituara, vlerëson se gjykata referuese nuk ka parashtruar argumente serioze për jokushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Ajo nuk ka arritur t`i ngrejë pretendimet e saj në nivel kushtetues, duke mos arritur të paraqesë argumente kushtetuese për papajtueshmërinë me nenet 4, 17, 18 dhe 41, të Kushtetutës të përmbajtjes së nenit 168/1 të Kodit Civil. Pretendimet e gjykatës referuese në thelb i referohen mënyrës se si duhet të interpretohet kjo dispozitë, si edhe mungesës së një praktike të unifikuar në lidhje me këtë interpretim, çka mbetet një detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk përbën objekt të juridiksionit kushtetues. Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë një rol aktiv dhe të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në ushtrimin e kompetencës së tyre për interpretimin e dispozitës ligjore, sepse u takon këtyre gjykatave që të zgjidhin problemet që rrjedhin nga keqinterpretimi i tekstit së dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Përpara se të pezullojë procesin gjyqësor dhe të kërkojë kontrollin incidental të normës, gjykata referuese duhet të verifikojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse nuk ka, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën, me qëllim garantimin e dhënies së drejtësisë efektive. Për rrjedhojë, gjykata referuese nuk ka plotësuar kërkesat për legjitimitimin e saj për inicimin e kontrollit incidental të normës”.

Siç shihet në rastin konkret gjyqtarit iu desh një kohë e gjatë (1 vit e 1 muaj e 6 ditë), i cili është në tejkalim të afatit ligjor 6-mujor, për të përcaktuar nëse dispozita ligjore përkatëse mund të kishte pasojë kushtetuese.

Nga informacioni në lidhje me vendimin që korrespondon me dokumentin 3, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 27.1.2015 dhe gjyqtari Engert Pëllumbi ka dalë me vendim për pezullimin e çështjes civile më datë 22.6.2016 dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për kushtetutshmërinë e nenit 26, paragrafi 2, germa “b”, të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

(çështja e regjistruar më 27.1.2015); vendimi për pezullim i datës 22.06.2016 (1 vit e 4 muaj dhe 25 ditë, jashtë afatit standard 6 muaj).

Në datën 14.10.2016 mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e përbërë prej 7 gjyqtarësh, përmes vendimit nr. ***, datë 14.10.2016, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentimin, ndër të tjera, si vijon: *“Sipas gjykatës, në kuptim të legjitimitetit për iniciimin e kontrollit incidental nuk është i mjaftueshëm vetëm identifikimi i lidhjes së drejtpërdrejtë, pra, të provuarit se dispozita e kundërshtuar do të zbatohet në çështjen konkrete, por është po aq e rëndësishme që vendimi për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në gjykatë të arsyetohet edhe nga pikëpamja e bazueshmërisë së çështjes në lidhje me parametrat kushtetues të referuar si të cenuar nga dispozita e kundërshtuar. Gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t’i drejtohet gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (shihni vendimin nr. 55, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë një rol aktiv dhe të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në ushtrimin e kompetencës për interpretimin e dispozitës ligjore, sepse u takon këtyre gjykatave të zgjidhin problemet që rrjedhin nga keqinterpretimi i tekstit të dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete”*. Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese në përfundim ka vlerësuar se: *“Gjykata referuese nuk ka plotësuar kërkesat për legjitimitimin e saj për iniciimin e kontrollit incidental të normës dhe kërkesa e paraqitur nga ana e saj nuk mund të pranohet për shqyrtim në seancë plenare”*.

Referuar analizës për këto tri çështje, u konstatua se subjekti i rivlerësimit, për 2 nga 3 çështjet e dërguara për kontroll incidental në Gjykatën Kushtetuese, nuk ka respektuar afatet standarde të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar.

Gjithashtu, për sa i përket zgjidhjes së çështjeve brenda nja afati të arsyeshëm kohor, referuar arsytimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pezullimi dhe dërgimi i këtyre tri çështjeve nga ana e gjykatës referuese pranë Gjykatës Kushtetuese nuk ka qenë rrugëzgjdhja e duhur e mosmarrëveshjeve të palëve.

Për gjetjet e mësipërme në lidhje me tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet si vijon:

“Për dy nga tre dokumentet e dorëzuara (vendime për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjet në Gjykatën Kushtetuese) më është dashur një kohë e gjatë nga fillimi i gjykimit deri në marrjen e vendimit të pezullimit. Lidhur me këtë konstatim dua të shpreh disa konsiderata.

Së pari, për sa i përket shkeljes ose jo të afatit të arsyeshëm për afatet që referohen në këto raste, argumentet shteruese i kam dhënë në shpjegimin që lidhet me gjetjet në raportin përfundimtar lidhur me çështjen që i përket paditësit S.Ç, kundër të paditurit B.H, me objekt “detyrimin për njohjen pronar, etj.”.

Së dyti, kontrolli incidental është mjeti i aksesit të gjyqtarit të zakonshëm në juridiksionin kushtetues. Përmes këtij mjeti procedural gjyqtari i zakonshëm kërkon shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të një norme të ligjit e cila është e zbatueshme në çështjen që ai ka për gjykim. Duke qenë operacioni më i lartë intelektual që një gjyqtar mund të bëjë, vendimmarrja për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese duhet të jetë një vendimmarrje e pjekur dhe që kërkon kohën e nevojshme. Kjo jo vetëm që, gjyqtari i zakonshëm të krijojë bindjen për antikushtetutshmërinë e normës, por, edhe të gjejë argumentet e nevojshme për t’ia parashtruar Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim, kam peshuar drejt nevojën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm të palëve ndërgjyqëse, nga

njëra anë, me nevojën për të eliminuar nga rendi juridik normën që çmohet antikushtetuese, nga ana tjetër. Për më tepër, në asnjë nga rastet e shqyrtuara palët nuk kanë pasur pretendime në lidhje me shkeljen e afatit të arsyeshëm.

Së treti, në raport aludohet se, pezullimi i gjykimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese është bërë për të shmangur zgjidhjen në themel të saj. Nga shqyrtimi i këtyre dosjeve rezulton se, jo vetëm çështjet janë zgjidhur në themel, por zgjidhja e tyre kurrsesi nuk mund të shmanget nga ana e gjyqtarit të zakonshëm, për sa kohë Gjykata Kushtetuese, brenda afateve të parashikuara në ligjin e saj do të shprehet me vendim për pranimin, mospranimin ose rrëzimin e kërkesës së gjykatës referuese. Kontrolli incidental në këto raste, nga ana e subjektit të rivlerësimit, është bërë që jo vetëm të zgjidhet çështja konkrete, duke eliminuar nga rendi juridik normën që çmohet si antikushtetuese, por që t'i jepet zgjidhje në mënyrë kushtetuese edhe të gjitha çështjeve të tjera në të cilat kjo normë është e zbatueshme.

Së katërti, nga studimi i praktikës së Gjykatës Kushtetuese konstatohet se një përqindje shumë e vogël e çështjeve të referuara nga gjyqtarët e zakonshëm kalojnë filtrin e kontrollit paraprak të pranueshmërisë dhe akoma në më pak raste pranohet kërkesa. Kjo nuk do të thotë se, gjyqtarët e zakonshëm nuk e kanë përgatitjen e duhur për të parashtruar çështje përpara Gjykatës Kushtetuese, por, se kjo gjykatë prirret gjithnjë drejt zgjidhjeve me sa më pak pasoja për rendin juridik, d.m.th prirret që t'i lejojë një marzh vlerësimi sa më të gjerë ligjvënësit në zgjidhjen e bërë prej tij me miratimin e ligjit si dhe përpiqet që t'i ftojë gjyqtarët për t'i bërë normave të ligjit interpretime kushtetuese sa të jetë e mundur, duke e bërë kontrollin incidental mjetin e fundit për të zgjidhur antikushtetutshmërinë e konstatuar. Një prirje e tillë vërehet në përgjithësi edhe nga gjykatat kushtetuese të vendeve evropiane, si Gjykata Kushtetuese Italiane dhe Gjykata Kushtetuese Gjermane. Megjithatë, kjo nuk mund dhe nuk duhet t'i dekurajojë gjyqtarët e zakonshëm që të heqin dorë nga përdorimi i këtij mjete për të intensifikuar komunikimin e tyre me gjykatat kushtetuese, duke ngritur problematika të natyrës kushtetuese.

Në tre dokumentet e paraqitura, edhe pse jam përpjekur që normës t'i bëj interpretim kushtetues, kam arritur në përfundimin se, zgjidhja e vetme ka qenë pezullimi i gjykimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar normën në fjalë si të papajtueshme me Kushtetutën. Personalisht jam një interpretues besnik i ligjit dhe mendoj që gjyqtari i zakonshëm edhe pse ka detyrimin që ligjit t'i bëjë interpretim kushtetues, ky interpretim nuk mund të shkojë deri në pikën që të ndryshohet përmbajtja e tij. Interpretimi i zgjeruar i normës, edhe pse është një prej llojeve të interpretimit gjyqësor, ka kufij. Nëpërmjet këtij interpretimi nuk mund të ndryshohet përmbajtja e normës dhe të tejkalohet qëllimi i vërtetë i ligjvënësit (ratio legis). Jam i palëkundur në pikëpamjen se shërimi i antikushtetutshmërisë së një norme bëhet më së pari nga ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese, pasi pushteti i gjyqtarit të zakonshëm është i kufizuar në këtë drejtim.

Së pesti, përzgjedhja prej meje e tre dokumenteve është bërë pikërisht për të më vlerësuar nivelin e arsytimit, thellësinë e njohurive dhe problematikat kushtetuese që kam ngritur. Mendoj se këto tre dokumente, në dallim nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, për të cilat ekziston informacioni i plotë për të gjitha veprimet procedurale dhe vendimet e marra, kanë si qëllim vetëm vlerësimin e njohurive dhe aftësive për të identifikuar problematikat dhe dhënien e zgjidhjeve përkatëse. Për të vlerësuar në tërësi një çështje të caktuar do të duhet që të administrohet i gjithë dokumentacioni që gjendet në dosje dhe nuk mund të gjykohej, si p.sh., për afatet, vetëm duke u nisur nga vendimi përfundimtar i gjykatës. Si subjekt rivlerësimi, nëse do të gjykoja më të rëndësishëm respektimin e afatit dhe elementëve të tjerë formalë, mund të kisha paraqitur edhe vendime të tjera me një arsyetim më modest. Për rrjedhojë, kam besimin që tre dokumentet e përzgjedhura prej meje do të vlerësohen për qëllimin për të cilin ato janë përzgjedhur dhe nuk do të përdoren për të konstatuar problematika kundër meje.

Së gjashti, nga leximi i të tre dokumenteve që kam paraqitur për vlerësimin profesional do të konstatoni që në to janë ngritur një sërë problematikash kushtetuese dhe se arsyetimi ka qenë i qartë, i pasur dhe shterues, duke treguar njohuri të thella për fushën. Në këto dokumente do të vini re që janë trajtuar parime dhe institute të së drejtës kushtetuese edhe të panjohura ose të patrajtuara në doktrinën dhe jurisprudencën tonë, por të mirënjohura dhe mirëtrajtuara në doktrinën dhe jurisprudencën e huaj, si procesi i rregullt ligjor legjislativ (legislative due process) një koncept i përpunuar nga doktrina dhe jurisprudenca anglosaksone, antikushtetutshmëria e normës si pasojë e ometimit legjislativ (lacuna legis) ose e njohur ndryshe nga doktrina dhe jurisprudenca italiane si shfuqizimi intelektual i normës, etj. Sakaq, Gjykata Kushtetuese ka pasur rastin dhe mundësinë për t'i trajtuar dhe bërë pjesë të saj këto koncepte. Madje, dua të shtoj se një pjesë të këtyre trajtimeve në kontrollet incidentale i kam zhvilluar edhe në formën e botimeve akademike, sikurse ka qenë shkrimi me titull “Probleme juridike të parashkrimit fitues me titull”, i botuar në Revistën Avokatia, nr. 30, prill 2019”.

Komisioni mori në konsideratë përgjigjet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjetjet e Komisionit dhe kalimin e shpjegimeve për tri (3) dokumentet ligjorë të paraqitur nga subjekti. Shpjegimet e subjektit ishin bindëse, pavarësisht disa problematikave, që sipas Komisionit qëndrojnë lidhur me iniciativën e tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me mekanizmin e kontrollit incidental. Subjekti, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën dhe zgjidhjen e çështjes gjyqësore, duke i garantuar palëve një proces të rregullt ligjor.

❖ Konstatimet mbi pesë (5) dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short në mënyrë rastësore dhe objektive.

Dosja 1 - Çështja civile nr. *** regj., datë 24.12.2013, që i përket paditësit shoqëria “****” sh.p.k., kundër të paditurit shoqëria “****”, dega Shqipëri, me objekt “detyrimin për pagimin e çmimit të shitjes së mallrave dhe kamatëvonesave..”, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 14.4.2014

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin e datës 26.12.2013, gjyqtari Engert Pëllumbi ka caktuar seancën përgatitore në datën 28.1.2014.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Engert Pëllumbi në sekretari në datën 16.4.2014, pas 2 ditëve nga shpallja, brenda afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 24.12.2013 – 14.4.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar në pikën 5, germa “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton edhe standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim nga subjekti norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 27.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht në arsyetim parime të përgjithshme të së drejtës.

Nga aktet në dosje rezulton se ky vendim është ankimuar nga pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë 13.11.2014, ka vendosur : “Lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 14.4.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

Dosja 2 - Çështja civile me nr. *** regj., datë 28.10.2014, që i përket paditësit S.Ç, kundër të paditurit B.H, me objekt “detyrimin për njohjen pronar, etj. “, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 13.11.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe në shortin elektronik të datës 28.10.2015 i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Engert Pëllumbi, ku me vendimin “Për kalimin e çështjes në seancë përgatitore”, të datës 29.10.2014, ka caktuar seancën përgatitore më 26.11.2014, duke urdhëruar njëkohësisht njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

Në dosje ndodhet e administruar kërkesa e gjyqtarit Engert Pëllumbi për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, datë 23.10.2015. Kërkesa është shqyrtuar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili me vendimin e datës 23.10.2015 ka vendosur: *“Të mos pranojë kërkesën e gjyqtarit Engert Pëllumbi dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes”*.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Engert Pëllumbi në kryesekretari në datën 20.11.2015, pas 7 ditëve nga shpallja, brenda afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 15 ditë, në intervalin kohor 28.10.2014 – 13.11.2015. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, germën “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton as standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 27.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht në arsyetim ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës.

Nga aktet në dosje, rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 1.6.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”*.

Edhe kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur dhe nga data 26. 7.2016, dosja ndodhet në pritje të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Dosja 3 - Çështja civile nr. *** regj., datë 15.1.2016, që i përket paditëses A.L, me të paditur B.L, me objekt “zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.4.2016

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në shortin e datës 19.1.2016 dhe seanca e pajtimit është caktuar më 5.2.2016, ora 9:00.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Engert Pëllumbi në kryesekretarinë e gjykatës në datën 13.4.2016, pas 6 ditëve nga shpallja, brenda afatit procedural civil 10-ditor, të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 18 ditë, në intervalin kohor 19.1.2016 – 7.4.2016. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 4-mujor të caktuar nga pika 5, e germës “d”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit të Familjes, Kodit të Procedurës Civile, vendimit unifikues nr. 2, datë 27.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht parime të përgjithshme të së drejtës.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse.

Dosja 4 - Çështja penale, gjykim i drejtpërdrejtë me nr. *** regj., datë 9.6.2014, që i përket të pandehurit D.B, i akuzuar për veprën penale “drejtim të automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.7.2014

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Engert Pëllumbi në datën 29.7.2014, pas 7 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 9.6.2014 – 22.0.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të caktuar në pikën 5, germa “a”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

Në dosje gjenden aktet e shqyrtimit të vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit për të pandehurin, aktet e paraqitura nga mbrojtja e të pandehurit, konkluzionet përfundimtare të palëve dhe fashikulli hetimor. Procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje nuk rezultojnë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, pasi në procesverbalin e fundit, konstatohet se nuk është pasqyruar dispozitivi i gjykatës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 346 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Nga aktet e administruara në dosje nuk rezulton të jetë ushtruar ankim kundër këtij vendimi.

Dosja 5 - Çështja administrativo-penale me nr. *** regj., datë 10.5.2015, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Fier, me objekt “vleftësimin e arrestit në flagrancë” dhe “caktimin e masës së sigurimit”, “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, për shtetasin S. P, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 12.5.2015

Kjo çështje është regjistruar në datën 10.5.2015, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin e datës 10.5.2015, gjyqtari Engert Pëllumbi ka caktuar seancën gjyqësore në datën 12.5.2013.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi në kryesekretarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 15.05.2015, pas 3 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka zgjatur gjithsej 45 orë dhe është brenda afatit procedural penal të 48 orëve, të përcaktuar në nenin 258 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 245 të Kodit Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Nga aktet në dosje rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGj-së. Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë. Në shumë raste, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shihni dosjet 1, 2, 3 dhe 4).

Ka njohuri të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Natyra e çështjeve që subjekti ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të tij të përftuara përmes përvojës në punë.

Duhet evidentuar se përgjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin Engert Pëllumbi janë paraqitur gjithsej në Inspektoratin e KLD-së, 4 ankesa. Tri ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi për dy prej tyre pretendimet për ligjshmëri vendimi zgjidheshin përmes apelimit gjyqësor në gjykatat e shkallëve më të larta, ndërsa një ankesë ishte e përsëritur.

Një ankesë është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar gjyqtarit Engert Pëllumbi, për efekt vlerësimi etik dhe profesional.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Engert Pëllumbi nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, apo të jetë propozuar në ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor (shihni të dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së).

Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shihni dosjet 1, 2 dhe 3) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shihni dosjet 4 dhe 5).

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve gjyqtari i kushton gjithmonë rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shihni dosjet 1, 2, 3 dhe 4). Një tipar i mirë i punës së tij është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nga pesë dosjet e vëzhguara, në asnjë rast nuk është cenuar vendim nga Gjykata e Apelit dhe as për shkak të procesit të parregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se gjithmonë disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët.

Gjithashtu, në të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi dhe gjithmonë kanë referuar edhe bazën ligjore.

Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, duke përcaktuar për periudhën tetor 2013 – janar 2014, fushën e të drejtës civile dhe nga janari i vitit 2014 dhe në vazhdim në seksionin penal të kësaj gjykate, pra fushën e të drejtës penale.

Subjekti ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1379 çështje, ka përfunduar gjithsej 1382 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 107 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 100,2 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Engert Pëllumbi ka përfunduar gjithsej 1375 çështje gjyqësore, nga të cilat 1076 çështje civile (416 civile themeli, 92 civile familjare, 189 civile të veçanta, 32 urdhra mbrojtje e 347 urdhra ekzekutimi) dhe 299 çështje penale (20 penale themeli, 8 administrativo-penale dhe 271 masa sigurimi).

Sipas pikës 3, germa “a”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtare në vit. Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Engert Pëllumbi ka qenë nën standardin minimal.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Engert Pëllumbi, në 4 raste ka qenë brenda afateve standard apo ligjore, por në një rast jashtë këtyre afateve dhe në intervale kohore nga 2 ditë (shihni dosjen 5) deri në 1 vit 15 ditë (shihni dosjen 2). Çështja, që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje civile, me objekt detyrimin për njohjen pronar, e shqyrtuar në 18 seanca, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimit pjesërisht, vendim i cili është ankimuar nga palët ndërgjyqëse dhe është lënë në fuqi nga gjykata e apelit (shihni dosjen 2). Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 13 ditë (shihni dosjen 4), 2 muaj e 18 ditë (shihni dosjen 3) dhe 3 muaj e 20 ditë (shihni dosjen 1). Në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj tij janë paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, 3 prej të cilave janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndërsa një ankesë është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar gjyqtarit Engert Pëllumbi, për efekt vlerësimi etik dhe profesional.

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Engert Pëllumbi i kushton rëndësi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, pa patur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej tij pas 2 ditëve (shihni dosjen 1), pas 3 ditëve (shihni dosjen 5) dhe pas 6 ditëve (shihni dosjen 3). Vetëm në një rast u konstatua se gjyqtari e ka dorëzuar dosjen penale jashtë afatit ligjor 5-ditor, pas 7 ditëve (shihni dosjen 4).

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari Engert Pëllumbi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Subjekti ka patur ngarkesë sasiore nën standardin minimal, por jo gjithmonë i ka kushtuar rëndësi gjykimit dhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në tri çështje civile të vëzhguara, subjekti ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shihni dosjet 1, 2 dhe 3). Në këto tri raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në tri çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 7, 18 dhe 3 seanca. Ndërsa në 2 çështjet penale të vëzhguara, një prej të cilave lidhet me vepër penale krim, ka përfunduar me 4 seanca dhe çështja tjetër administrativo-penale, vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi, është përfunduar me 1 seancë (shihni dosjet 4 e 5). Rezulton se në dosjen e katërt, penale, seancat gjyqësore janë shtyrë duke respektuar afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Konkretisht janë vëzhguar gjithsej 33 seanca gjyqësore, nga të cilat 26 kanë qenë produktive. Pengesë në 7 seanca joproduktive kanë qenë: kërkesa për shtyrje e palës paditëse (2 seanca), mosparaqitja e ekspertit (2 seanca), kërkesa për shtyrje e palës së paditur (1 seancë), mosformimi i trupit gjykues, për mosparaqitje të vetë gjyqtarit (1 seancë) dhe mosparaqitja e prokurorit (1 seancë).

Gjatë gjykimit, subjekti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar e gjer tek shpallja e vendimit.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shihni dosjet 1, 2 e 3) ose penale (shihni dosjet 4 e 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, gjithashtu, të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, sipas kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

Konstatohet se 7 nga 33 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim *audio*, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Sa i përket fillimit me vonesë të seancës gjyqësore, rezultoi se nga 33 seanca të vëzhguara gjithsej, në 13 prej tyre është konstatuar vonesë në çeljen e seancës gjyqësore nga 16 minuta deri në 1 orë e 7 minuta, për të cilat në shumicën e rasteve, pasi u dëgjuan edhe regjistrimet në audio të seancave, është pasqyruar dhe dokumentuar shkaku. Në rastin e vonesës më të madhe 1 orë e 7 minuta, tek seanca gjyqësore e datës 9.3.2015, në dosjen ***, është relatuar si shkak “angazhimi i gjyqtarit në një çështje penale”.

Gjyqtari Engert Pëllumbi ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2006 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Fillimin në detyrë e ka me dekretin nr. ***, datë. 27.9.2010, të Presidentit të Republikës, kur është emëruar gjyqtar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me dekretin nr. ***, datë 21.12.2011, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Më pas,

me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, të KLD-së, i është akorduar leje 3-vjeçare për të shërbyer si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë dhe me vendimin nr. ***, datë 23.1.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor i është zgatur komandimi edhe një vit. Rezulton, gjithashtu, se me vendimin nr. ***, datë 27.10.2020, të KLGJ-së është vendosur komandimi i gjyqtarit Engert Pëllumbi në skemën e delegimit dhe është caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë deri më 5.11.2021.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi. Në pesë dosjet e vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Engert Pëllumbi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara, nuk është konstatuar që palët të kenë paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarit, ndërsa nuk u konstatuan raste dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë në 15 trajnime, gjithsej 29 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi ka deklaruar se nuk ka marrë pjesë në aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Për gjetjet e mësipërme në lidhje me pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura në mënyrë rastësore dhe objektive, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Referuar gjetjeve nga vlerësimi profesional, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar e sqaruar si vijon¹²:

Në raportin përfundimtar lidhur me rezultatet e hetimit theksohet se, në çështjen që i përket paditësit Sulo Çuadëraj, kundër të paditurit B.H, me objekt “detyrimin për njohjen pronar, etj.” gjykimi ka zgatur gjithsej 1 vit e 15 ditë, në intervalin kohor 28.10.2014 - 13.11.2015. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Lidhur me këtë konstatim dua të jap këto shpjegime: përcaktimi i afatit të arsyeshëm për gjykimin e një mosmarrëveshje nuk mund të bëhet bazuar në një akt nënligjor (vendimi i ish

¹²Më tepër sqarime mund të gjeni te shpjegimet e sjella nga subjekti në qëndrimin përfundimtar të tij ndaj rezultateve të hetimit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë). Akti nënligjor të cilit i referohet nëpunësi përgjegjës për vlerësimin është miratuar me qëllim për të bërë vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, në funksion të renditjes së tyre (në bazë të pikëzimit) për efekt të karrierës, duke qenë një bazë krahasimi për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore për secilin gjyqtar.

Rezulton se, në këtë çështje është paraqitur padi dhe kundërpadi, është urdhëruar kryerja e dy ekspertimeve, është kërkuar thirrja e personit të tretë, është kërkuar përjashtimi i gjyqtarit si dhe palët kanë bërë shpesh herë kërkesa për shtyrjen e gjykimit. Referuar statistikave të ngarkesës në punë për vitin 2015 kam gjykuar gjithsej 505 (pesëqind e pesë) çështje, pra, 2.5 (dy pikë pesë) herë më tepër se standardi prej 200 vendimesh në vit, sipas akteve nënligjore të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

*Në raportin përfundimtar, lidhur me rezultatet e hetimit, theksohet se për çështjen me nr. *** regj, datë 9.6.2014, që i përket të pandehurit D.B, i akuzuar për veprën penale të “drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.7.2014, procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje nuk rezultojnë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, pasi në procesverbalin e fundit, konstatohet se nuk është pasqyruar dispozitivi i gjykatës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 346 të Kodit të Procedurës Penale.*

Lidhur me këtë konstatim dua të jap këto shpjegime. Nëse vërehet me kujdes procesverbali për gjykimin e kësaj çështje është mbajtur me sistemin audio. Në këtë kuptim, procesverbal në këtë rast nuk janë shënimet e mbajtura nga sekretarja gjyqësore, por CD-ja e regjistrimit audio të seancës gjyqësore. Ky përfundim mbështetet në konkluzionet e vendimit unifikues nr. 1, datë 27.4.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në raportin përfundimtar, lidhur me rezultatet e hetimit, theksohet se 1 ankesë e vitit 2013 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar për efekt vlerësimi etik e profesional, gjyqtarit Engert Pëllumbi.

Lidhur me këtë ankesë, e cila është paraqitur nga shtetasi S.A, dhe për të cilën është evidentuar si shkelje mosrespektim formal i ligjit, duke u evidentuar për efekt vlerësimi etik e profesional, kam paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të sipërpërmendur dhe detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mos e marrë parasysh në vlerësimin e gjyqtarit Engert Pëllumbi, duke e çregjistruar dhe hequr nga dosja atë.

Në raportin përfundimtar lidhur me rezultatet e hetimit theksohet se unë kam punuar nga janari i vitit 2014 e në vazhdim në seksionin penal të kësaj gjykate, pra fushën e të drejtës penale, dhe se sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore ka qenë nën standardin minimal.

Po t'i referohemi urdhrave të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se vazhdimisht ka qenë pjesë e Dhomës Civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe asnjëherë pjesë e dhomës penale, edhe pse ka gjykuar çështje penale, si ato të fazës së hetimeve paraprake, si gjyqtar i gatshëm, si dhe çështje të tjera penale si pasojë e papajtueshmërisë së gjyqtarëve të Dhomës Penale.

Në të njëjtën kohë, po t'i referohemi evidencave të ngarkesës në punë ndër vite rezulton se jo vetëm ngarkesa në punë nuk ka qenë nën standardin minimal, por ajo e ka tejkaluar me dy herë këtë standard.

Në raportin përfundimtar lidhur me rezultatet e hetimit theksohet se 7 nga 33 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Nisur nga numri i vogël i sallave, ngarkesa e madhe e punës, sikurse rezulton nga të dhënat statistikore për këtë gjykatë, të paraqitura si provë nga ana ime, ka qenë e pamundur që të gjitha seancat të zhvilloheshin me sistemin e regjistrimit audio. Kjo ka qenë arsyeja që 7 nga 33 seancat e zhvilluara prej meje, në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë regjistruar me sistemin audio. Nga ana tjetër, të gjitha seancat gjyqësore, të cilat janë seanca ku zhvillohet debati mbi provat, janë zhvilluar me sistemin audio. Pra, çdo seancë që është zhvilluar në sallë është mbajtur me sistemin audio.

Komisioni, pasi analizoi gjetjet mbi vlerësimin profesional, nisur nga fakti se tri dosjet janë të përzgjedhura nga vet subjekti, vlerëson iniciativën ligjore të subjektit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me mekanizmin e kontrollit incidental, si dhe nivelin e shpjegimeve bindëse të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit si dhe çmon se subjekti ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Mangësitë e konstatuara lidhur me tri praktikatat e paraqitura nga subjekti dhe vlerësimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short, nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar subjektin të papërshtatshëm dhe marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Për subjektin e rivlerësimit janë regjistruar në Komision 4 denoncime.

1. Denoncim nr. * prot., datë 27.4.2018, i shtetasit M.S**

Ky denoncues ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to, edhe subjektin e rivlerësimit “për shkelje ligjore, njëanshmëri duke favorizuar palën kundërshtarë dhe duke mos thirrur personat që kanë marrë lekët nga unë ...”.

Nga studimi i akteve ligjore të sjella bashkëlidhur ankesës së denoncuesit nuk rezultojnë *indicie* lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit, përkundrazi subjekti i rivlerësimit në vendimin gjyqësor objekt ankimi duket se ka bërë një shpjegim të mirë të rrethanave të çështjes në kuptim të Kodit Civil lidhur me titujt ekzekutivë e rastet e pavlefshmërisë së tyre.

2. Denoncim nr. * prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A.Rr**

Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, ndër to, edhe gjyqtarin Engert Pëllumbi “*për dhënie vendimesh të padrejta dhe në shkelje ligjore të hapur*”.

Nga studimi i ankesës së tij konstatohet se organi i Prokurorisë së Rrethit Fier, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë shqyrtuar çështje gjyqësore familjare penale me kërkuese ish-bashkëshorten e shtetasit A.Rr dhe nga ai personalisht. Në të gjithë parashtrimin që bën denoncuesi nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

3. Denoncim nr. * prot., datë 12.4.2018, i përsëritur i shtetas L.Z**

Kjo denoncuese ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to, edhe subjektin e rivlerësimit “*për dhënie vendimesh në shkelje të Kodit Penal dhe të Kushtetutës, si dhe në shkelje të etikës duke zhvilluar gjyqet pa audiencë*”. Duke studiuar vendimin bashkëlidhur denoncimit, konkludohet se nuk rezultojnë *indicie* për hetime të mëtejshme, lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë kemi të bëjmë me çështje vendimmarrje gjyqësore të ankimeshme.

Ndërsa në lidhje me ankesën e shtetas L.Z “*për zhvillimin e gjyqeve pa audiencë, iu kërkuua subjektit të japë shpjegime për këtë fakt konkret*”.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

*“Të gjitha seancat për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit O.T, i akuzuar dhe dënuar për kryerjen e veprës penale “vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, e parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal, janë zhvilluar me dyer të hapura. Kjo provohet mjaft lehtë nga përmbledhësja e procesverbalit gjyqësor, në të cilën është cituar për çdo seancë se ajo zhvillohet me dyer të hapura. Gjithashtu, për sa kohë nuk është marrë një vendim për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura, prezumohet se ai ka qenë publik. Deklaroj me përgjegjësi të plotë se në disa nga seancat e zhvilluara për këtë proces gjyqësor ka marrë pjesë jo vetëm denoncuesja, e cila është nëna e të dënuarit O.T, por edhe Avokati A.K, anëtar i Dhomës së Avokatëve Fier. Kjo provohet edhe deklaratën noteriale të lëshuar prej tij, me nr. ***, datë 21.9.2021, e Noterit L.M, të cilën e bashkëlidh si provë me këtë diskutim. Së fundi, fakti që denoncuesja ka marrë pjesë në këto seanca provohet, ndër të tjera, edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 22.06.2015, ku unë, me cilësinë e kryesuesit të seancës kam urdhëruar nxjerrjen jashtë sallës së gjykimit të shtetases L.Z, për shkak të shkeljes së rregullave të solemnitetit në gjykim.*

*Vendimi nr. ***, datë 24.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me të cilën i pandehuri O.T është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprave penale të “vrasjes me dashje e kryer në rrethana të cilësuar” dhe “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, të parashikuara nga nenet 79, germa “dh” dhe 278, paragrafi II i Kodit Penal, është lënë në fuqi edhe nga shkallët e tjera të pushtetit gjyqësor”.*

Sa më sipër, rezulton se subjekti dha shpjegime bindës në lidhje me kërkesën e Komisionit për ankesën e denoncueses L.Z.

4. Denoncim nr. * prot., datë 2.4.2021, i Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion të Shqipërisë**

Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion ka kërkuar marrjen e masave duke monitoruar gjyqtarin Engert Pëllumbi aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar më parë në gjykatën e rrethit gjyqësor Fier.

Denoncuesit pretendojnë se gjatë monitorimit të gjykimeve të gjyqtarit kanë vënë re veprime korruptive dhe vonesa të cilat kanë çuar në dëm të interesave të qytetarëve dhe shtetit. Gjithashtu, pretendojnë se gjyqtari në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Për këtë Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për të kërkuar kopje të vendimeve e praktikave gjyqësore për dy subjekte paditëse me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Engert Pëllumbi.

Në përgjigje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka dërguar aktet e dosjes civile me nr. ***, datë 1.2.2016, me palë kërkuese shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator E.M dhe aktet e dosjes civile me nr. ***, datë 1.2.2017, me palë kërkuese E.F.

Referuar dokumentacionit në dosjen me palë kërkuese E.M konstatohet se në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., E.M dhe shtetasit F.M kanë nënshkruar një aktmarrëveshje me nr. ***, datë 30.4.2013, ku ky i fundit merr përsipër ndjekjen e punimeve për ndërtimin e një godine 9 (nëntë) kate në lagjen “****”, rruga “****”, Fier, për një afat kohor 2-vjeçar, ku shtetasi E.M i kishte dhënë prokurë të posaçme shtetasit F.M, që i lejonte kryerjen e të gjitha veprimeve në emër të shoqërisë. Me kalimin e afatit 2-vjeçar duke mospërmbushur detyrimet shtetasit F. M, E.M i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesën për sigurim padie, ku kërkon bllokimin e të gjitha shumave në të holla të shtetasit F.M dhe të pronarëve të truallit V. K. dhe H. M. të depozituara në të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe bllokimin e të gjitha pasurive të tyre në lidhje me moszbatimin e aktmarrëveshjes së sipërcituar. Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e palës kërkuese dhe i ballafaqoi ato me provat e

administruara, vlerësoi se kërkesa ishte e pabazuar në prova dhe shkresa dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

Ndërsa lidhur me aktet e dosjes civile me nr. ***, datë 1.2.2017, me palë kërkuese E.F, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me gjyqtar E. Pëllumbi ka vendosur kthimin e kërkesë padisë dhe të akteve të saj, për shkak se pala kërkuese nuk kishte paguar taksën mbi aktet, si dhe aktet e përfaqësimit rezultojnë me të meta, duke qenë se nuk konfirmohej nëse lëshuesi i autorizimit për av. N. H., kryetari i shoqatës së avokatëve antikorrupsion, av. N.P, e kishte ose jo një tagër të tillë, si dhe nëse kjo shoqatë kishte ose jo të drejta për të përfaqësuar shtetas të ndryshëm në procese gjyqësore. Pas caktimit të një afati, pala kërkuese i ndreq pjesërisht të metat e padisë duke paguar taksën mbi aktet, por në lidhje me të metat e përfaqësimit, pala paraqet vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku rezultojnë se kryetar i shoqatës është zgjedhur av. N.P, por që nuk rezultojnë që ky i fundit të ketë të drejtë të përfaqësojë personat fizikë ose juridikë në gjykatë, me përjashtim të shtresave në nevojë, çka nuk ishte rasti i kërkuarit E. F. Në këndvështrim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile thuhet se *kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera*. Ndodhur në këto kushte, meqenëse pala kërkuese nuk i ka ndrequr të gjitha të metat e padisë brenda afatit të lënë, do të vendoset kthimi i kërkesëpadisë së bashku me aktet e tjera.

Sa më sipër, referuar studimit të akteve të dosjeve të mësipërme, sipas ankesës së Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion të cilët, *gjatë monitorimit të gjykimeve të gjyqtarit Engert Pëllumbi kanë vënë re veprime korruptive; vonesa të cilat kanë çuar në dëm të interesave të qytetarëve dhe shtetit dhe pretendimit të tyre se, gjyqtari në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrime të ndryshme*, konstatohet se parë në aspektin procedural, vendimet që ka marrë subjekti i rivlerësimit janë në akordancë të plotë me situatat faktike të paraqitura dhe nuk evidentohen veprime korruptive në aspektin procedural-formal, si dhe atë thelbësor të çështjeve të studiuara.

Për sa më sipër, Komisioni pasi kreu hetim të hollësishëm mbi këto denoncime, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Engert Pëllumbi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar gremës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Engert Pëllumbi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi